

LIGJ
Nr. 105/2013

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 083, DATË 23.2.2009 “PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE
EVN AG, STATKRAFT AS E DEVOLL HYDROPOWER, SH.A., SI
BASHKËKONCESIONARË PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN
NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT
TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e dytë e “Kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower, sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë”, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS e Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Importi dhe furnizimi brenda vendit i mallrave dhe shërbimeve, që lidhen me projektin e hidrocentralit në lumin Devoll, gjatë fazës së parandërtimit dhe fazës së ndërtimit (siç janë përkufizuar në kontratën e koncesionit, të ndryshuar), do t'i nënshtrohen regjimit specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar, siç përcaktohet në shtesën e dytë të kontratës së koncesionit. Dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm për tatimin mbi vlerën e shtuar nuk do të zbatohen nëse vijnë në kundërshtim me regjimin specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar, të përcaktuar në shtesën e dytë të kontratës së koncesionit.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Financave që, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim për zbatimin e nenit 2 të këtij ligji, si dhe të dispozitave të shtesës së dytë të kontratës së koncesionit, që lidhen me regjimin specifik të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.3.2013

Shpallur me dekretin nr. 8096, datë 12.4.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

SHTESA E 2-TË E KONTRATËS SË KONCESIONIT
NË LIDHJE ME PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI,
SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË
HIDROCENTRALIT NË LUMIN E DEVOLLIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË MES
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS (SI AUTORITETI
KONTRAKTUES) DHE EVN AG, STATKRAFT AS, DHE DEVOLL HYDROPOWER SHA (SI
BASHKËKONCESIONARË)

Kjo Shtesë e 2-të lidhet mes Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si Autoriteti Kontraktues dhe Statkraft AS, dhe Devoll Hydropower sh.a., si Bashkëkoncesionarë dhe EVN AG (në vijim e quajtur “Marrëveshja” ose “Shtesa e 2-të”), 19.3.2013.

Kjo Shtesë e 2-të e Kontratës së Koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në Lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë e lidhur në datë 19 dhjetor 2008, e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet ligjit nr. 10 083, datë 23 shkurt 2009 dhe e publikuar në Fletoren Zyrtare me numër 28, datë 17 mars 2009, dhe e plotësuar nga shtesa e parë e Kontratës së Koncesionit, datë 3 gusht 2010, e cila është miratuar me ligjin nr. 10 337, datë 21 tetor 2010 dhe e publikuar në Fletoren Zyrtare numër 154, datë 24 nëntor 2010 (Kontrata e Koncesionit), është lidhur sot më datë 19.3.2013, midis:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, e ndodhur në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, 1001 Tiranë, Shqipëri (METE ose Autoriteti Kontraktues); dhe

2. a) Statkraft AS, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Norvegjisë me seli në Lilleakerveien 6, 0283 Oslo, Norvegji, dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Norvegjisë me numër shoqërie 987 059 699 (Statkraft);

b) Devoll Hydropower sh.a., një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: Rr. “Papa Gjon Pali II”, ABA Business Center, Zyra nr. 1204, Tiranë, Shqipëri dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit e Republikës së Shqipërisë (Shoqëria Koncesionare);

bashkërisht “Bashkëkoncesionarët”; dhe

3. EVN AG, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Austrisë me seli në EVN Platz 2344 Maria Enzersdorf, Austri dhe e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive të Gjykatës Tregtare të Wiener Neustadt me numër shoqërie 72 000 h (EVN).

Secili prej Autoritetit Kontraktues, Bashkëkoncesionarëve dhe EVN do të quhen individualisht “Pala” dhe bashkërisht “Palët”. Meqenëse:

A. Palët kanë rënë dakord që të drejtat dhe detyrimet e EVN sipas Kontratës së Koncesionit do t’i transferohen Statkraft dhe se EVN do të çlirohet nga detyrimet e saj të përcaktuara në Kontratën e Koncesionit.

B. Autoriteti Kontraktues dhe Bashkëkoncesionarët kanë rënë dakord të zbatojnë Projektidenë e Rishikuar, siç përcaktohet në shtojcën A bashkëngjitur dhe të kushtëzojnë Ndërtimin e Hidrocentralit të Kokelit me përmbushjen e disa kushteve, siç përmenden në nenin 3.10 të kësaj Shtese të 2-të.

C. Autoriteti Kontraktues dhe Bashkëkoncesionarët kanë rënë dakord që të parashikojnë zbatimin e skemës së autofaturimit të TVSH-së (*reverse charge*) për disa furnizime mallrash dhe shërbimesh, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje. Pranohet se një ligj i ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar”, është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 20 dhjetor 2012 (ligji nr. 125/2012), i cili, ndër të tjera, parashikon përjashtimin nga TVSH-ja për: i) importin e makinerive dhe pajisjeve për realizimin e

kontratave të investimit me një vlerë prej 50.000.000 lekësh ose më shumë; dhe ii) importin dhe furnizimin brenda vendit të hekurit dhe të çimentos ndaj personave që ndërtojnë hidrocentrale, të cilët i përdorin ato si lëndë e parë në ndërtimin e hidrocentraleve. Është rënë dakord se Bashkëkoncesionarët mund të vendosin, sipas gjykimit të tyre, për kategori të ndryshme furnizimesh ndaj Projektit të Devollit, nëse do të zbatohet përjashtimi nga TVSH-ja i dhënë nga ligji i sipërpërmendur ose regjimi i autofaturimit i parashikuar nga kjo Marrëveshje.

Për këtë arsye, duke marrë parasysh sa më lart, palët bien dakord si vijon:

1. Interpretimi

Çdo fjalë me gjuhë të madhe, e cila nuk është përkufizuar në Shtesën e 2-të do të ketë kuptimin që i është caktuar kësaj fjale në Kontratën e Koncesionit.

2. Transferimi i të drejtave dhe i detyrimeve të EVN të Statkraft

2.1 Autoriteti Kontraktues nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje konfirmon miratimin e tij për transferimin e kuotave të EVN në Shoqërinë Koncesionare të Statkraft ose një prej Shoqërive të kontrolluara prej saj në përputhje me nenin 5.1 të Kontratës së Koncesionit.

2.2 Palët bien dakord se me efekt nga data e hyrjes në fuqi dhe efekt të plotë të kësaj Shtese të 2-të në përputhje me nenin 5.1 (Data Efektive):

a) EVN do të përfundojë, për të gjitha qëllimet, së qeni një palë e Kontratës së Koncesionit dhe nuk do të ketë të drejta të tjera, përfitime, detyrime ose përgjegjësi lidhur me të, qofshin aktuale, të përlogaritura, të mundshme ose tjetër dhe pavarësisht nëse lindin në, përpara ose pas Datës Efektive;

b) Statkraft do të marrë përsipër të gjitha të drejtat, përfitimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e EVN, sipas Kontratës së Koncesionit, qofshin aktuale, të përlogaritura, të mundshme ose tjetër dhe, pavarësisht nëse lindin në, përpara ose pas Datës Efektive; dhe

c) Autoriteti Kontraktues do të çlirojë dhe do të shkarkojë EVN nga përgjegjësia për të respektuar, për të zbatuar dhe për të përmbushur secilën prej detyrimeve të marra përsipër nga Statkraft në lidhje me Kontratën e Koncesionit dhe do të pranojë respektimin, zbatimin dhe përmbushjen e këtyre detyrimeve nga ana e Statkraft.

2.3 Përveçse siç ndryshohet shprehimisht nga kjo Shtesë e 2-të, dispozitat e Kontratës së Koncesionit do të vazhdojnë të jenë në fuqi me efekt të plotë dhe detyrues mbi Autoritetin Kontraktues dhe Bashkëkoncesionarët, për aq sa ato janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe detyruese menjëherë përpara Datës Efektive.

3. Ndryshimet

3.1 Përkufizimet e mëposhtme në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit do të ndryshohen si vijon:

“Bashkëkoncesionarë” nënkupton Statkraft dhe Shoqërinë Koncesionare.

“Hidrocentrale” nënkupton Hidrocentralin e Banjës, Hidrocentralin e Moglicës dhe Hidrocentralin e Kokelit.

Përkufizimet e mëposhtme në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit do të shfuqizohen:

““Aksionari Kryesor”;

“Hidrocentrali i Lozhan-Grabovës”;

“Hidrocentrali i Skënderbegas-Cekini””.

Përkufizimet e mëposhtme do të përfshihen në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit, siç është e përshtatshme:

“NBK e Parashikuar” nënkupton normën e brendshme të kthimit të hidrocentraleve të llogaritur nga Koncesionari në përputhje me nenin 7.2.2.

“Kushtet e Kokelit” ka kuptimin që i jepet në nenin 7.2.2.

“Hidrocentrali i Kokelit” nënkupton hidrocentralin hidroelektrik për t’u ndërtuar në dhe rreth zonës së njohur si Kokel në Luginën e Lumit të Devollit, siç parashikohet në shtojcën A, në pajtim me Kërkesat Teknike Minimale, përfshirë të gjitha punimet civile dhe të gjitha instalimet

elektromekanike, përfshirë, por pa u kufizuar te turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse të ndërtesës së centralit, transformatorët, pajisjet e nënstacionit dhe linjën e transmetimit deri në pikën e miratuar të livrimit të energjisë në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.

“Kontraktor i nivelit 1” nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të Shoqërisë Koncesionare, siç është emëruar nga Shoqëria Koncesionare në përputhje me nenin 2.8.5.

“Kontraktor i nivelit 2” nënkupton një kontraktor të drejtpërdrejtë të çdo Kontraktori të Nivelit 1, siç është emëruar nga shoqëria koncesionare në përputhje me nenin 2.8.5.

“Hidrocentrali i Moglicës” nënkupton hidrocentralin hidroelektrik për t’u ndërtuar në ose rreth zonës së njohur si Moglicë në Luginën e Lumit të Devollit, siç parashikohet në shtojcën A, në pajtim me Kërkesat Teknike Minimale, përfshirë të gjitha punimet civile dhe të gjitha instalimet elektromekanike, përfshirë, por pa u kufizuar te turbinat, gjeneratorët, pajisjet ndihmëse të ndërtesës së centralit, transformatorët, pajisjet e nënstacionit dhe linjën e transmetimit deri në pikën e miratuar të livrimit të energjisë në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike.

“Projektideja e Rishikuar” nënkupton specifikimet teknike për hidrocentralet, përgatitur nga Koncesionari, siç parashikohet në shtojcën A.

“Tatimi mbi vlerën e shtuar” ose “TVSH” nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar në përputhje me ligjin shqiptar nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, siç ndryshohet kohë pas kohe dhe çdo tatim të ngjashëm të zbatueshëm ndaj furnizimit të mallrave dhe shërbimeve dhe importit të mallrave.”

3.2 Në nenin 2.2.1 (c) dhe 2.3 (a), fjalët “810 metra mbi nivelin e detit m.m.n.d.” do të ndryshohen në “650 metra mbi nivelin e detit m.m.n.d.”.

3.3 Neni i mëposhtëm do të shtohet pas nenit 2.7 të Kontratës së Koncesionit:

“2.8 Regjimi i TVSH-së

2.8.1 Zbatimi i TVSH-së në importin e mallrave. Për sa i përket importimit gjatë Fazës së Parandërtimit dhe Fazës së Ndërtimit të të gjitha makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër, që lidhet me Projektin, në atë masë që këto importe nuk janë të përjashtuara sipas ligjit të përmendur në preambulën C më lart, importuesi nuk do të ketë detyrim për pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar pranë autoriteteve doganore që duhej kryer në lidhje me këto importe.

Ky import mallrash do të trajtohet si një furnizim mallrash i kryer nga importuesi për veten e tij si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të importuesit për të paguar këtë tatim mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për të zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar në përputhje me nenin 2.8.6.

Ky nen 2.8.1 zbatohet vetëm ndaj importeve të Shoqërisë Koncesionare ose çdo Kontraktori të Nivelit 1.

2.8.2 Zbatimi i TVSH-së në shërbimet ndërkombëtare. Për sa u përket shërbimeve të lidhura me Projektin, të cilat janë subjekt i TVSH-së në Republikën e Shqipërisë dhe që kryhen nga furnitorë të huaj shërbimesh për Shoqërinë Koncesionare ose për një Kontraktor të Nivelit 1, gjatë Fazës së Parandërtimit dhe Fazës së Ndërtimit, duke përfshirë shërbimet që lidhen me pasurinë e paluajtshme që ndodhet në Shqipëri vetëm personi, të cilit i janë furnizuar shërbimet do të jetë përgjegjës për pagesën pranë administratës tatimore të çdo tatimi mbi vlerën e shtuar, që është i detyrueshëm për t’u paguar në lidhje me këto shërbime.

Këto shërbime do të trajtohen si shërbime të kryera nga personi, të cilit i janë furnizuar shërbimet, për veten e tij si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike, me efekt lindjen e detyrimit të personit, të cilit i janë furnizuar shërbimet për të paguar tatimin mbi vlerën e shtuar ndaj administratës tatimore dhe të drejtën e tij për ta zbritur këtë tatim mbi vlerën e shtuar në përputhje me nenin 2.8.6.

Furnitorët e huaj të shërbimeve për furnizimet e të cilëve zbatohet ky regjim nuk kanë detyrim për regjistrim pranë administratës tatimore.

2.8.3 Zbatimi i TVSH-së në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve brenda vendit. Për sa u përket furnizimeve brenda vendit: i) të makinerive dhe pajisjeve, linjave teknologjike, automjeteve, lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe çdo malli tjetër; si edhe ii) të të gjitha shërbimeve, në çdo rast, të lidhura me projektin gjatë Fazës së Parandërtimit dhe Fazës së Ndërtimit, vetëm personi, të cilit i janë kryer furnizimet do të jetë përgjegjës për pagesën pranë administratës tatimore të çdo tatimi mbi vlerën e shtuar, që është i detyrueshëm për t'u paguar në lidhje me këto furnizime dhe do të ketë të drejtë ta zbresë këtë tatim mbi vlerën e shtuar në përputhje me nenin 2.8.6.

Ky nen 2.8.3 zbatohet vetëm për furnizime të kryera nga: i) një Kontraktor i Nivelit 1; dhe ii) një Kontraktor i Nivelit 2.

2.8.4 Në faturat e lëshuara nga furnizuesi për furnizimet, siç përcaktohet në nenin 2.8.3, nuk do të llogaritet apo pasqyrohet TVSH-ja.

Trajtimi i furnizimeve, siç përcaktohet në nenin 2.8.3, nuk ndikon tek e drejta e furnizuesit për të zbritur TVSH-në në blerje njësoj sikur furnizimi i tij të ishte një furnizim i tatueshëm me TVSH, sipas rregullave të përgjithshme të TVSH-së.

2.8.5 Për qëllimet e regjimit të TVSH-së, të përcaktuar në nenet 2.8.1 deri në 2.8.3 më lart, Shoqëria Koncesionare mund të emërojë gjithsej deri në dyzet e pesë (45) Kontraktorë të Nivelit 1 dhe Kontraktorë të Nivelit 2 (në çdo kohë) dhe do të ketë, gjithashtu të drejtën që më pas të zëvendësojë çdo Kontraktor të Nivelit 1 ose Kontraktor të Nivelit 2 të emëruar.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të autorizohet që të miratojë emërimin e Kontraktorëve të Nivelit 1 ose Kontraktorëve të Nivelit 2 shtesë, përveç dyzet e pesë (45) kontraktorëve të përmendur më lart, nëse kërkohet nga Shoqëria Koncesionare. Ky miratim nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

Regjimi i TVSH-së, i përcaktuar në këtë nen 2.8, do të zbatohet për Kontraktorët e Nivelit 1 dhe Kontraktorët e Nivelit 2 të emëruar si më lart.

Shoqëria Koncesionare do të hartojë një listë me të gjithë Kontraktorët e Nivelit 1 dhe Kontraktorët e Nivelit 2, dhe do të paraqesë një listë të përditësuar në rast të ndonjë ndryshimi. Këto ndryshime bëhen efektive tri javë pas dërgimit të listës së përditësuar. Lista do t'i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, sipas rastit.

2.8.6 Importuesi sipas nenit 2.8.1, si edhe personi, të cilit i janë furnizuar mallrat ose shërbimet në përputhje me nenin 2.8.2 dhe nenin 2.8.3, do të lëshojë një faturë tatimore shitjeje për veten, ku do të rezultojë si furnizues dhe blerës i mallrave dhe i shërbimeve në të njëjtën kohë (autofaturim) dhe ka të drejtë që në mënyrë të menjëhershme të zbresë nga TVSH-ja e llogaritur mbi shitjet që i korrespondojnë këtyre importeve ose furnizimeve të mallrave ose shërbimeve, TVSH-në e zbatuar në këto blerje në të njëjtën shumë; pra nuk do të bëhet një pagesë me para në dorë pranë administratës tatimore, me kusht që importuesi ose personi, të cilit i janë kryer furnizimet të ketë të drejtë të zbresë këtë TVSH në blerje sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit të zbatueshëm.

2.8.7 Çdo veprim ose mosveprim i çdo enti shtetëror në shkelje të këtij neni 2.8 ose çdo shkelje tjetër nga ndonjë ent shtetëror në vënien në funksionim dhe zbatimin e regjimit të TVSH-së, siç përcaktohet në këtë nen 2.8, përbën një shkelje thelbësore të një detyrimi thelbësor sipas Kontratës së Koncesionit.

2.8.8 Shoqëria Koncesionare do të krijojë një sistem të rregullave të përputhshmërisë për Kontraktorët e Nivelit 1 dhe Kontraktorët e Nivelit 2 dhe do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar zbatimin e regjimit të TVSH-së, siç përcaktohet në këtë nen 2.8, në mënyrë që të shmanget në masën maksimale të mundshme keqpërdorimi i tij.

Nëse Shoqëria Koncesionare merr dijeni për shkeljen ose abuzimin me rregullat e përputhshmërisë ose regjimin e TVSH-së, në një mënyrë thelbësore, Shoqëria Koncesionare do të njoftojë Autoritetin Kontraktues se Kontraktori i Nivelit 1 dhe Kontraktori i Nivelit 2 që ka kryer shkeljen është hequr me efekt të menjëhershëm nga lista e përmendur në nenin 2.8.5 më lart dhe regjimi i TVSH-së i përcaktuar në këtë nen 2.8, nuk do të zbatohet më ndaj këtij kontraktori.”.

3.4 Neni në vijim do të shtohet pas nenit 3.3.7 të Kontratës së Koncesionit:

“3.3.8 Afatet në nenet 3.3.5 deri në 3.3.7 nuk do të zbatohen për Hidrocentralin e Kokelit, për të cilin do të zbatohen të mëposhtmet:

a) çdo ndryshim i Projektit të Detajuar dhe i certifikatave të sigurimit do t'i jepen Autoritetit Kontraktues përpara fillimit të ndërtimit të Hidrocentralit të Kokelit; dhe

b) Koncesionari do të finalizojë punët përgatitore të ndërtimit, si p.sh. në veçanti tenderimin nga ana e Koncesionarit për punët ndërtimore thelbësore dhe kontratat për ndërtime thelbësore civile për Hidrocentralin e Kokelit më ose përpara 18 muajve, pasi të jenë përmbushur Kushtet e Kokelit në përputhje me nenin 7.2.2.”.

3.5 Në nenin 3.6 fjalja e parë do të ndryshohet si vijon:

“Fillimi i Fazës së Ndërtimit do të konsiderohet se ndodh në datën në të cilën secili prej angazhimeve të dhëna në nenin 3.3 dhe 3.4 do të jetë përmbushur për sa u përket Hidrocentralit të Banjës dhe Hidrocentralit të Moglicës (ose hequr dorë nga Autoriteti Kontraktues në masën që lejohet nga ligji).

(Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit).”.

3.6 Neni 5.1 do të ndryshohet si vijon:

“Gjatë Afatit, Statkraft do të kontrollojë Shoqërinë Koncesionare, me kusht që gjithsesi: i) Statkraft do të ketë të drejtë të transferojë lirisht aksionet e Shoqërisë Koncesionare te ndonjë prej filialeve të tij në çdo kohë gjatë afatit, në qoftë se ky transferim nuk do të çojë në transferimin e kontrollit nga Statkraft, si dhe çdo transferim tjetër (përfshirë një transferim të Kontrollit) do të jetë objekt i miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktues, i cili nuk do të refuzohet ose vonohet në mënyrë të paarsyeshme; me kusht që më tej, në lidhje me ndonjë transferim të propozuar (përfshirë një transferim kontrolli), Autoriteti Kontraktues do t'u kushtojë vëmendjen e duhur eksperiencës, situatës financiare (që do të përfshijë mbështetjen kredituese të palëve të treta), qëndrueshmërisë dhe reputacionit të përfituesit të transferimit të propozuar.”.

3.7 Në nenin 5.2 fjalët “Aksionarët Kryesorë” do të zëvendësohen me “Statkraft”.

3.8 Në nenin 5.3 fjalët “Aksionarët Kryesorë” dhe “Secili prej Aksionarëve Kryesorë” do të zëvendësohen me “Statkraft”.

3.9 Në nenin 5.4.2 fjalët “Aksionarët Kryesorë” do të zëvendësohen me “Statkraft”.

3.10 Neni 7.2.2 do të ndryshohet si vijon:

“Koncesionari do të fillojë ndërtimin e:

a) Hidrocentralit të Banjës në Datën e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit;

b) Hidrocentralit të Moglicës në kohën e nevojshme për të finalizuar ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës në përputhje me nenin 7.2.3;

c) Hidrocentralit të Kokelit, pasi të përmbushen Kushtet e Kokelit, pas përfundimit të punëve përgatitore të Ndërtimit për Hidrocentralin e Kokelit sipas nenit 3.3.8 (b); dhe përfundojë ndërtimin e hidrocentraleve në përputhje me praktikën e mira të industrisë.

Detyrimet e Koncesionarit për të filluar punët përgatitore të ndërtimit dhe më pas ndërtimin e Hidrocentralit të Kokelit do t'i nënshtrohen përmbushjes së të gjitha kushteve të mëposhtme (Kushtet e Kokelit):

i) Pajtimi me detyrimet sipas marrëveshjes ose ligjit.

Autoriteti Kontraktues dhe ente të tjera shtetërore përkatëse do të jenë gjatë gjithë kohës respektive, në përputhje me:

- Regjimin e TVSH-së së parashikuar nga neni 2.8 i kësaj Kontrate, ligjin nr. 125/2012, që ndër të tjera, përcakton përjashtimin nga TVSH-ja të importit të makinerive dhe pajisjeve dhe ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të TVSH-së;

- Çdo detyrim për të dëmshpërblyer ose për të paguar sipas kësaj Kontrate, duke përfshirë, por pa u kufizuar në nenin 2.2.1 (d) (Përmbushja e detyrimeve të shërbimit publik dhe kufizimeve të tjera ligjore, që ndalojnë shitjen e lirë ose eksportin e çdo pjese të prodhimit neto të energjisë

elektrike), 2.4.3 (Dëshmshpërblim në rast rritjesh të taksave). 2.4.4 (Dëshmshpërblim për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ose taksën e planifikimit të territorit); 7.2.6 (dështim për të ndërtuar në kohë infrastrukturën zëvendësuese); 10.3.7 (Veprime thelbësisht të dëmshme të qeverisë) dhe 14.3 (Dëshmshpërblim në rast pretendimesh të palëve të treta dhe humbje të drejtpërdrejta);

- Detyrimi sipas nenit 3.4.3 për të rinovuar dhe/ose dhënë të gjitha autorizimet e kërkuara për qëllim të ndërtimit të Hidrocentralit të Kokelit;

- Detyrimet sipas nenit 3.4.5 dhe 3.4.6 për t'i vënë Sheshet në dispozicion, për të dhënë të drejta uzufrikti dhe kryerjen e çdo shpronësimi të nevojshëm për Hidrocentralin e Kokelit; dhe

- Të gjitha detyrimet e tjera thelbësore sipas kësaj Kontrate, çdo marrëveshje tjetër mes Shoqërisë Koncesionare dhe çdo enti shtetëror dhe ligjit shqiptar.

ii) Kushtet që lidhen me tregun

Autoriteti Kontraktues, Korporata Elektroenergjietike Shqiptare sh.a. (KESH), çdo shoqëri në pronësi publike ose ent shtetëror që kryen gjenerimin ose shpërndarjen e energjisë:

- do të ketë përmbushur në të gjitha periudhat përkatëse, detyrimet për pagesë për çdo energji të shitur nga Koncesionari ndaj një entiteti të tillë, duke marrë parasysh edhe ndonjë afat shtesë për pagesë, sipas marrëveshjeve përkatëse për blerjen e energjisë;

- nuk do të kufizojë në çdo kohë të drejtën e Koncesionarit për të eksportuar lirisht prodhimin neto të energjisë elektrike, përveçse kur ky kufizim lejohet nga ligji shqiptar; dhe

- do të ketë krijuar një treg funksional të mirë dhe likuid në Shqipëri, në përputhje me angazhimet për përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë sipas Traktatit Europian të Komunitetit të Energjisë.

iii) Rentabiliteti

NBK-ja e parashikuar për hidrocentralet do të jetë në një nivel minimum prej 10%, sipas llogaritjeve të bëra nga Koncesionari në përputhje me parimet e Kontratës së Koncesionit dhe praktikën e zakonshme të industrisë. Këto llogaritje do t'i vihen në dispozicion Autoritetit Kontraktues.

Jo më vonë se një vit përpara datës së planifikuar nga Koncesionari për përfundimin e ndërtimit të Hidrocentralit të Moglicës, Koncesionari do të rishikojë përmbushjen e kushteve të përcaktuara më lart, përfshirë marrjen e të dhënave të nevojshme për llogaritjen e NBK-së së Parashikuar dhe do të informojë Autoritetin Kontraktues për çdo kusht, që sipas Koncesionarit nuk është përmbushur. Palët, në kushtet e mirëbesimit, do të fillojnë nga ky moment e tutje, diskutimet për të verifikuar nëse Kushtet e Kokelit janë përmbushur dhe plotësuar.

Nëse NBK-ja e Parashikuar sipas llogaritjeve të Koncesionarit është më pak se 10%, këto diskutime do të përfshijnë çdo masë që mund të ofrohet nga Autoriteti Kontraktues, në mënyrë që të arrihet një NBK e parashikuar prej 10% për hidrocentralet në përputhje me parimet e Kontratës së Koncesionit.

Nëse ndonjë prej Kushteve të Kokelit, i parashikuar në pikat "i" dhe "ii" më lart, nuk është plotësuar apo përmbushur ose nëse kushti i parashikuar në pikën "iii" më lart, nuk është përmbushur dhe Palët nuk kanë rënë dakord mbi masat e nevojshme për të arritur një NBK të Parashikuar prej 10% për hidrocentralet në përputhje me parimet e Kontratës së Koncesionit, brenda 120 ditësh nga përfundimi i ndërtimit të Hidrocentralit të Moglicës, atëherë të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit dhe të Autoritetit Kontraktues sipas kësaj Kontrate, për sa i përket Hidrocentralit të Kokelit do të përfundojnë, përveçse kur Palët kanë mosmarrëveshje, siç përcaktohet më poshtë ose kur bihet dakord ndryshe nga Palët. Në rast të ndonjë zgjidhjeje sipas këtij neni:

a) Autoriteti Kontraktues ose ndonjë ent tjetër përkatës shtetëror kanë të drejtë t'u japin palëve të treta të drejta koncesionare mbi Lumin Devoll, midis nivelit më të lartë të rregulluar të ujit të Hidrocentralit Kokel dhe nivelit më të lartë operacional të rrjedhjes së Hidrocentralit të Banjës, siç specifikohet në shtojcën A bashkëngjitur, me kusht që Autoriteti Kontraktues ose ndonjë ent

tjetër shtetëror nuk do të japë të drejta, të cilat kanë efekte negative mbi Hidrocentralin e Banjës ose Hidrocentralin e Moglicës, siç specifikohet në nenin 2.4.2 “i” dhe “ii”;

b) Koncesionari do t’i transferojë Autoritetit Kontraktues punët e tij, për Projektin e Detajuar për Hidrocentralin e Kokelit, pa kundërshtim; dhe

c) “Vëllimi i Kontraktuar i Prodhimit” do të ulet në 52 TWh.

Në rast mosmarrëveshesh midis Palëve nëse ndonjë nga Kushtet e Kokelit, të përcaktuara në pikat “i” dhe “ii” më lart, janë përmbushur apo plotësuar dhe kur kjo mosmarrëveshje nuk është zgjidhur në përputhje me nenin 13.1, atëherë kjo mosmarrëveshje mund të referohet nga secila Palë në arbitrazh në përputhje me nenin 13.3. Është rënë dakord që derisa kjo mosmarrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim ose arbitrazh, të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit lidhur me Hidrocentralin e Kokelit nuk do të përfundojnë. Më tej, koncesionari nuk do të ketë asnjë detyrim të fillojë punët përgatitore të ndërtimit dhe/ose ndërtimin e Hidrocentralit të Kokelit, dhe për të evituar ndonjë dyshim, nuk do të jetë përgjegjës për asnjë humbje apo dëm që mund të lindë si pasojë e mosfillimit të punëve përgatitore të ndërtimit dhe/ose të ndërtimit në periudhën derisa të jetë zgjidhur mosmarrëveshja, me kusht që Koncesionari të ketë vepruar arsyeshëm kur ka pretenduar mospërmbushjen e Kushteve të Kokelit”.

3.11 Në nenin 7.2.3, paragrafi i parë do të ndryshohet si vijon:

“Koncesionari do të ndërtojë:

a) Hidrocentralin e Banjës në mënyrë që të arrihet Përfundimi Paraparak, jo më vonë se 36 muaj nga Data e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit, datë e cila do të përbëjë një “Datë grafiku”;

b) Hidrocentrali i Moglicës në mënyrë që të arrihet përfundimi paraparak jo më vonë se Data e Planifikuar e Përfundimit të Punimeve të Ndërtimit, datë e cila do të përbëjë një “Datë grafiku”.

c) Hidrocentrali i Kokelit, me kusht që të jenë përmbushur Kushtet e Kokelit, në mënyrë që të arrihet Përfundimi Paraparak jo më vonë se 54 muaj pas afatit përfundimtar të fillimit të ndërtimit të Hidrocentralit të Kokelit, sipas nenit 7.2.2 (c), datë e cila do të përbëjë një “Datë Grafiku”.

3.12 Në nenin 7.3.11 (a), fjala “një Hidrocentral” do të zëvendësohet me “Hidrocentrali i Banjës ose Hidrocentrali i Moglicës”.

3.13 Neni 7.3.14 (c) do të ndryshojë si vijon:

“Autoriteti Kontraktues bie dakord që shumica fillestare e Sigurimit të Kontratës do të zvogëlohet me:

i) euro 16 milionë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final për Hidrocentralin e Banjës (minus ndonjë shumë që është tërhequr për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Banjës).

ii) euro 28 milionë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final për Hidrocentralin e Moglicës (minus ndonjë shumë që është tërhequr për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Moglicës).

iii) euro 6 milionë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit final për Hidrocentralin e Kokelit (minus ndonjë shumë që është tërhequr për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Kokelit).”.

3.14 Në nenin 11.2 (d) fjalët “ose Aksionarët Kryesorë” do të hiqen.

3.15 Në nenin 14.10.2 adresat për njoftime ose komunikime për Koncesionarin do të zëvendësohen me sa vijon:

“Devoll Hydropower sh.a.

Në vëmendje të: Drejtorit të Përgjithshëm

Rr. “Papa Gjon Pali II”

ABA Business Center

Zyra nr. 1204

Tiranë, Shqipëri”.

3.16 Shtojca A e Kontratës së Koncesionit do të zëvendësohet tërësisht me shtojcën e re A bashkëngjitur kësaj Shtese të 2-të.

4. Miratimi nga komisioni i ndihmës shtetërore

Autoriteti Kontraktues konfirmon që Komisioni shqiptar i Ndhmës Shtetërore ka miratuar termat dhe kushtet e Kontratës së Koncesionit dhe të kësaj Shtese të 2-të.

5. Miratimi nga Këshilli i Ministrave dhe ratifikimi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

5.1 Palët pranojnë se Shtesa e 2-të do të hyjë në fuqi dhe do të ketë efekt të plotë në rrethanën që ndodh e fundit prej: i) nënshkrimit të saj nga Palët; ii) datës së miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë; iii) 15 ditë pas datës së publikimit të ratifikimit të Shtesës së 2-të nga Kuvendi i Shqipërisë në Fletoren Zyrtare (Fletorja Zyrtare shqiptare); dhe iv) datës së regjistrimit të transferimit të aksioneve të EVN në Shoqërinë Koncesionare të Statkraft ose të ndonjë prej Filialeve të tij, në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë Koncesionare.

5.2 Duke ratifikuar këtë Marrëveshje, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë autorizon Autoritetin Kontraktues për të vepruar dhe për të lidhur këtë Marrëveshje për llogari të Republikës së Shqipërisë, e cila do të bëhet në këtë mënyrë Palë e kësaj Marrëveshjeje.

6. Të ndryshme

6.1 Palët bien dakord që dispozitat e përcaktuara në nenet 14.2 nga 14.4 deri në 14.6, 14.8 dhe nga 14.10 deri në 14.16 të Kontratës së Koncesionit do të zbatohen *mutatis mutandis* ndaj Shtesës së 2-të. Palët më tej bien dakord që dispozitat e arbitrazhit të përcaktuara në nenet 13.3.2 deri në 13.3.4 do të zbatohen gjithashtu ndaj Shtesës së 2-të.

Në dëshmi të sa më lart, Shtesa e 2-të është nënshkruar nga përfaqësues të palëve të autorizuar në mënyrë të rregullt në ditën, muajin dhe vitin e përmendur më lart.

Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë.

Stratkraft AS

Devoll Hydropower sh.a.

EVN AG

SHTOJCA A

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIDESË SË RISHIKUAR TË KONCESIONARIT, PËRSHKRIMI TEKNIK

A. Kërkesat teknike minimale

a) Projektideja e Rishikuar dhe Projekti i Detajuar

Koncesionari ka përgatitur Projektidenë e Rishikuar për luginën e Devollit, me qëllim kryesor shfrytëzimin e potencialit hidroenergjetik, duke arritur fleksibilitetin maksimal lidhur me prodhimin e energjisë. Synimi parësor i projektit të propozuar është të arrijë kërkesat e parashikuara të energjisë elektrike, ndërkohë që minimizon impaktin social dhe mjedisor.

Projektideja e Rishikuar do të shërbejë si një bazë e përgjithshme për Projektin e Detajuar për t'u dorëzuar nga Koncesionari në aplikimin e tij për një leje ndërtimi. Projekti i Detajuar mund të devijojë nga Projektideja e Rishikuar, si rezultat i shqyrtimeve të mëtejshme të hollësishme gjeologjike, hidrologjike, mjedisore dhe teknike, që mund të kryhet nga Koncesionari pas miratimit të Projektidesë së Rishikuar, me kusht që, megjithatë, këto devijime nuk do të çojnë në një ndryshim të totalit të kapacitetit të instaluar për të gjitha hidrocentralet në total prej jo më shumë se plus/minus 20% të 319 MW, dhe me kusht që përdorimi i potencialit të lumit të jetë bërë nga të paktën tri hidrocentrale në zonën e Projektit.

b) Strukturimi i hidrocentraleve

Projekti ndodhet të paktën disa 50 ose 70 km në juglindje të Tiranës në pjesën qendrore-lindore të Shqipërisë, në jug të lumit të Shkumbinit. Zona i përket administrativisht prefekturës së Elbasanit dhe të Korçës dhe është pjesë e Rajonit Malor qendror jugor të Shqipërisë.

Lumi i Devollit e ka burimin e tij në Malet e Gramozit në një lartësi prej 1500-1700 m mbi nivelin e detit. Pasi kalon luginën e Korçës në drejtim perëndimor, lumi i Devollit hyn në rajonin malor të Gorës afër qytetit të Maliqit, duke krijuar një luginë të ngushtë brenda formacioneve ranore dhe argjilore.

Lugina vazhdon të ngushtohet akoma më tej përmes shkëmbinjve ultrabazikë dhe shkëmbinjve ranoro/argjilorë të Paleogjenit.

Zona karakterizohet nga procese aktive erozioni me transport të konsiderueshëm sedimentesh në lumin e Devollit dhe degëve të tij dhe sedimenteve përgjatë pjesëve të ulëta, të gjera të luginës së Devollit, e cila ka pjerrësi më të ulët lumore.

Projekti përfshin tri hidrocentrale që përdorin prurjet nga zona ujëmbledhëse prej 2 890 km² në rrjedhën e sipërme të Banjës në një lartësi shfrytëzimi nga 650 m m.n.d. në Moglicë deri poshtë në 95 m m.n.d. në Banjë.

Projekti hidroenergjetik ka këto të dhëna kryesore:

Hydrocentrali	Shkarkimi i projektuar	Kapaciteti i instaluar (Turbina)	Prodhimi mesatar
HEC-i i Moglicës	65 m ³ /s	177+1.2 MW	445 GWh/vit
HEC-i i Kokelit	73 m ³ /s	35.2 MW	92 GWh/vit
HEC-i i Banjës	95 m ³ /s	63.4 MW+min 1.4 MW	252 GWh/vit
Gjithsej		278.2 MW	789 GWh/vit

Sipas shpronësimit të tokës, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari do të respektojë dhe do të ruajë të drejtat ekzistuese të palëve të treta për të marrë ujë për vaditje deri në masën që këto të drejta kanë qenë ligjërisht të autorizuar dhe faktikisht të përdorura në Datën Efektive.

c) Pritshmëria e jetëgjatësisë së Projektit dhe Standardet e Ndërtimit

Pritshmëria e jetëgjatësisë së projektit dhe standardet e ndërtimit do të jenë në përputhje me praktikën e industrisë së mirë dhe standardet Europiane.

B. Shfrytëzimi i potencialit hidroenergjetik të lumit të Devollit

Zona ujëmbledhëse e lumit të Devollit ka një model prurjesh të theksuara sezonale me verë të thatë dhe dimër të lagësht. Vërshimi mesatar vjetor në digën e Banjës është i përlogaritur në 1 484 milionë m³.

Hydrocentrali i sipërm, hec-i i Moglicës do të shtrihet në një seksion të lumit të Devollit me gjatësi 22 km dhe një rënie prej 300 m. Vepra marrëse në hec-in e Moglicës ndodhet në rezervuarin e krijuar nga një digë me mbushje shkëmbore me një lartësi prej 150 m me bërthamë qendrore prej asfalto-betoni e njohur si Diga e Moglicës. Centrali ndodhet në sipërfaqen e tokës në shpatin verior të lumit të Devollit, dhe tuneli shkarkues është në pjesën e sipërme fundore të rezervuarit që do të krijohet nga një digë 53 m e lartë, e njohur si Diga e Kokelit.

Hydrocentrali i mesëm, hec-i i Kokelit, do të ndodhet në një shtrirje të lumit të Devollit me gjatësi 5.4 km me një lartësi shfrytëzimi prej rreth 55 m. Pjesa më e madhe e lartësisë së shfrytëzimit krijohet nga Diga e Kokelit, 50 m e lartë. Një pjesë e digës është e përbërë nga masiv betoni, pjesa tjetër është digë me mbushje guri me një ekran asfalti në anën e sipërme të mbushjes së digës. Godina e hec-it ndodhet mbi tokë në këmbë të digës.

Hydrocentrali i poshtëm, hec-i i Banjës, ndodhet në një seksion gjatësor prej 16 km në lumin e Devollit me një lartësi shfrytëzimi prej 77 m. Diga është projektuar si një digë me argjinaturë me një lartësi maksimale prej rreth 85 m mbi shtratin fillestar të lumit. Diga ka një bërthamë argjile të papërshkueshme. Centrali i ndodhur mbi tokë dhe kanali shkarkues fundor ndodhen në rrjedhën e poshtme të digës në shpatin jugor.

Pjesë të hidrocentralit të Banjës janë tashmë të ndërtuara, me punime të ndërmarra midis fundit të viteve 1980 dhe 1995. Pritat dhe tubacioni i devijimit me porta hyrëse janë përfunduar. Shkarkuesi fundor mundëson devijim në një nivel të ulët të lumit të Devollit. Gjatë prurjeve të larta në rezervuar, rezervuari i krijuar mundëson një grumbullim të ujit për të zbutur prurjet e shkarkimit në anën e poshtme. Ndërtimi i digës kryesore, përfshirë galerinë çimentuese, është përfunduar deri në një nivel prej 125 m dhe 130 m mbi nivelin e detit. Brenda kufirit të majtë është gërmuar dhe përfunduar pjesërisht tuneli hyrës dhe ai devijues. Këto struktura janë inspektuar dhe janë konsideruar të një cilësie të mjaftueshme si bazë për vazhdimin e ndërtimit. Është gërmuar, gjithashtu, një gropë në zonën e propozuar për godinën e centralin.

Hidrologjia

Lumi i Devollit (3140 m²) është dega kryesore e lumit Seman (5950 km²), ndërkohë që degët më të mëdha të lumit të Devollit janë Tomorricë (320 km²), Malsisë (300 km²) dhe Dunavecit (275 km²), lumi i Devollit kalon përmes disa zonave të ndryshme klimaterike. Karakteristikat kryesore të këtyre zonave klimaterike janë verë e thatë dhe dimër i lagësht.

Për shkak të pozicionit gjeografik dhe largësisë nga deti, reshjet ndryshojnë dukshëm përgjatë lumit. Rrjedha e sipërme e basenit lumor ka nivelin më të ulët të reshjeve në Shqipëri, ndërkohë që pjesa malore e zonës së mesme arrin sasi dukshëm më të larta. Zona është, gjithashtu, e karakterizuar nga një intensitet i ulët reshjesh, me mesatare vjetore maksimumi 24 orë reshje me vlerë prej 40-80 mm. Dëborë në dimër është e zakonshme dhe maksimumi i monitoruar i trashësisë së dëborës është deri në 2 m. Numri i ditëve të mbuluara me dëborë në vit mund të variojë nga rreth 30 ditë në pjesët e ulëta, deri në rreth 90 ditë në zonat malore.

Janë kryer analiza gjithëpërfshirëse mbi të dhënat për prurjet dhe reshjet për zonën ujëmbledhëse. Vlerat mesatare vjetore të prurjeve për sheshet e digave në rrjedhën kryesore janë vlerësuar në bazë të të dhënave nga periudha 1953-2005.

1.1.1.1.1.1 Prurjet mesatare vjetore në sheshet e digës

Sheshi i digës	Sipërfaqja (km ²)	HRWL* (m m.n.d.)	OFWL** (m m.n.d.)	Prurjet mesatare vjetore		
				(l/s/km ²)	(m ³ /s)	mil m ³ /vit
Moglicë	1671	650	651.5	13.1	21.8	689
Kokel	1885	350	350	14.4	27.1	854
Banjë	2890	175	176.5	16.3	47.1	1484

* HRWL = niveli më i lartë rregullator i ujit.

** OFWL = niveli më i lartë i ujit gjatë operimit (do të përdoret për kontrollin e përmbytjeve).

Kapaciteti depozitues i rezervuarëve

	Moglicë	Kokël	Banjë	Gjithsej
Vëllimi i shfrytëzueshëm (mil m ³)	152	15.2	178	345.2
Vëllimi i vdekur (mil m ³)	210	4.3	213	427.3

Sizmologjia

Shqipëria gjendet në rripin sizmik të Mesdheut Alpin dhe përbën pjesë të lidhjes mes mikroplakave të Adriatikut dhe pllakave euroaziatike. Sizmiciteti në vend karakterizohet nga një aktivitet intensiv tërmetesh të vogla dhe tërmetesh mesatare të ndryshme nga ngjarje të mëdha. Shkaku kryesor për veprimtarinë sizmike në Shqipëri është goditja midis mikroplakave të Adriatikut dhe formimit të maleve shqiptare.

Të gjitha strukturat do të vlerësohen për ngarkesa tërmeti. Metoda e projektimit, gati statike ose dinamike, do të zgjidhet në bazë të karakteristikave të elementeve të projektuara dhe klasifikimit sipas sigurisë/pasojave të tyre. Elementet strukturore do të diferencohen sipas pasojave të dështimit të tyre. Strukturat, ku humbja e funksionalitetit ka pasojë të mëdha, përfshirë diga dhe struktura të tjera kritike për sigurinë e digës, do të kontrollohen për një periudhë kthimi prej 1 në 500 vjet si një ngarkesë e ndryshueshme dhe 1 në 10 000 vjet si një ngarkesë aksidentale. Struktura të tjera do të kontrollohen vetëm për një periudhë kthimi prej 1 në 2000 vjet si një ngarkesë aksidentale. Kombinime të ndryshme ngarkesash pa pasur humbje në funksionueshmëri, duhet të tolerohen, ndërsa për kombinime aksidentale ngarkesash mund të tolerohen dëmtime mbi struktura, por nuk duhet të ndodhë shembje.

Faktorët e ngarkesës/faktorët e sigurisë do të jenë në përputhje me rekomandimet përkatëse ndërkombëtare dhe kodet e projektimit.

C. Hec-i i Moglicës, skema e përgjithshme

Hydrocentrali i Moglicës është Hydrocentrali i sipërm i të tria hidrocentraleve që formojnë Projektin Hidroenergetik të Devollit.

Diga e Moglicës, së bashku me veprën e marrjes ndodhet përafërsisht 1.5 km poshtë pikës së bashkimit të lumit të Malsisë dhe lumit të Devollit, ndërkohë që shkarkimi i kanalit fundor ndodhet në lumin e Devollit rreth 300 m sipër pikës së bashkimit midis degës së Grabovës dhe lumit të Devollit.

Godina e centralit nëntokësor ndodhet në shpatin verior përafërsisht 1.25 km jug-juglindje të bashkimit të degës Grabovë me lumin Devoll.

Skema shfrytëzon një lartësi maksimale shfrytëzimi/rënie prej 300 m midis HRWL në rezervuarin e Moglicës në lartësinë prej 650 m mbi nivelin e detit poshtë deri në HRWL në rezervuarin e Kokelit në një lartësi prej 350 m mbi nivelin e detit. Si masë për reduktimin e përmbajtjeve, kuota e ujit në digën e Moglicës mund të shkojë deri në 651.5 m mbi nivelin e detit. Nga vepra marrëse në lartësinë prej 610 m mbi nivelin e detit, prurja llogaritëse prej 65 m³/s e turbinave transmetohet përmes tunelit të devijimit prej 10.8 km të gjatë prej të cilit rreth 6.5 km do të gërmohen nga një makineri për hapjen e tuneleve (TBM) dhe pjesa e mbetur me shpim dhe teknika shpërthimi.

Në fund të rrjedhës së poshtme të tunelit të devijimit, uji do të hyjë në dy tubacione çeliku paralele me një diametër prej 3.2 m, përkatësisht 50 m dhe 65 m të gjatë, që të çojnë te dy turbinat Francis. Një tunel fundor 890 m i gjatë me një seksion të tërthortë prej 37 m² rikthen rrjedhën e turbinës në lumin e Devollit.

Në zonën e projektit mund të arrish nga zonat e rrjedhës së sipërme dhe ato të poshtme nga një rrugë që shkon paralelisht me lumin përmes luginës së Devollit.

Projekti përfshin pjesët kryesore si në vijim:

- diga e Moglicës, një digë me mbushje shkëmbore 150 m e lartë me një bërthamë asfalti të vendosur në qendër (ACC);

- tuneli i poshtëm i shkarkimit dhe tuneli i derivimit, me porta ndaluese në veprën e marrjes dhe 2 porta rrëshqitëse;

- tuneli i sipërm i shkarkimit me dy porta rrëshqitëse;

- një kapërderdhës me porta në shpatin e djathtë me 3 porta radiale, një rrëshqitëse dhe një pus shuarjeje;

- një hydrocentral të vogël në këmbë të digës për të përdorur rrjedhën e lirë mjedisore;

- hyrjen me skarë për mbledhjen e mbetjeve dhe një portë rrotulluese për tunelin e derivimit të ujit, të kombinuar me një hyrje për hydrocentralin e vogël dhe pajisjet për pastrimin dhe hidrothithjen e sedimenteve;

- mikrotunele të veshura, një për hydrocentralin e vogël dhe një për sistemin e pastrimit dhe të hidrothithjes së sedimenteve;

- një tunel derivimi 10.8 km i gjatë me 3 tunele inspektimi;

- një tunel i pjerrët i vërshimit me një gjatësi prej 0.8 km;

- dy tubacione nëntokësore të mëdha çeliku, nga një për secilën turbinë;

- një central nëntokësor me një shpellë dhe një shpellë për transformatorin, të dyja të lidhura me sipërfaqen e tokës nëpërmjet një tuneli 0.5 km të gjatë dhe një tuneli të veçantë prej 0.7 km të gjatë, tunel i kombinuar shpëtimi dhe kalimi të kablllove. Një tunel fundor 0.9 km të gjatë, i cili të çon në rezervuarin e krijuar nga diga e Kokelit në lumin e Devollit;

- një mekanizëm ndalues në dalje të tunelit shkarkues fundor;

- një tunel 0.2 km të gjatë të kombinuar me tunele hyrëse dhe tunele vërshimi për në shkarkuesin fundor;

- një godinë portale në tunelin e kalimit; dhe
- një nënstacion me godinë kontrolli;
- një linjë transmetimi 220 kV prej 51.5 km të gjatë mes nënstacionit të Elbasanit II dhe hec-it të Moglicës;
- një linjë 35 km e gjatë 22 kV për shpërndarje në sheshet e ndryshme të ndërtimit.

Gjeologjia

Zona e Digës së Moglicës

Diga e Moglicës ndodhet në një kanion shumë të pjerrët në shpatin e djathtë. Pjesa më e madhe e digës gjendet në një masiv konglomerat, i cili shtrihet mbi flishet (Flysch). Kufiri mes dy llojeve të shkëmbinjve përkulet 25-30 gradë drejt verilindjes. Themeli në shpatin e majtë përbëhet nga shkëmbinj dhe mbetje “të pakonsoliduara” deri në një thellësi të hamendësuar prej përafërsisht 100 m.

Njësitë kryesore litologjike brenda përkuljeve ose thyerjeve të shesheve të digës janë:

- konglomeratet;
- masive të gurëve ranorë;
- alternim gurësh ranorë dhe argjilorë.

Inspektimet tregojnë depërtueshmëri mesatare dhe deri atë të lartë dhe në 20 m e sipër të konglomeratit dhe thellësi mesatare deri në të ulët në thellësi. Pritet të ketë zona subhorizontale, pjesërisht të mbushura, të cilat mund të kërkojnë veshje.

1.1.1.1.2 Skema dhe projekti i përgjithshëm nëntokësor

Baza për tunelin dhe skemën e projektit është një vend i caktuar i veprës së marrjes në sheshin e Digës së Moglicës dhe një vendndodhje lokale e optimizuar e tunelit shkarkues. Vendndodhja e centralit dhe sistemi i tuneleve përkatëse është kryesisht i rregulluar nga kriteret teknike që vijnë si pasojë e projektimit të hidrocentralit, kushteve topografike dhe gjeologjike.

Shtirjet e propozuara, vendndodhjet dhe konceptet korresponduese për projektimin e tunelit konsiderohen të pranueshme dhe në një anë konservatore në këtë fazë të projektimit, bazuar në njohurinë aktuale gjeologjike, mekanike, tabela standardesh dhe eksperiencë praktike.

Shtirja e rekomanduar për vijën e ujit është përzgjedhur në bazë të rrugës më të shkurtër të mundshme, duke konsideruar mjaftueshëm mbulimin e anës, mbingarkimin dhe nivelin e ujit nëntokësor.

Skema e organizimit të tunelit për vijën e ujit është e ndarë në seksionet në vijim:

- Tuneli i derivimit Moglicë-Shemsit është i dominuar nga një seri flishesh të ndërprera nga shtresa ranore dhe konglomerate. Ky seksion do të gjërmohet nga një makineri për shpimin e tunelit, e cila vazhdon instalimin e veshjes segmentale për të gjithë shtirjen.

- Tuneli i derivimit në pjesën e sipërme të tunelit hyrës të Shemsit është gjërmuar për të takuar TBM nga vepra marrëse e Moglicës. Ky seksion është rekomanduar si tunel konvencional shpim e shpërthim, pjesa më e madhe e pritshme të jetë e veshur me beton.

- Tuneli i Shemsit deri në tunelin inspektues të derivimit, supozohet se ndodhet mbi shkëmbinj të fortë ofiolitikë dhe supozohet të gjërmohet me metoda konvencionale shpim e shpërthim.

- Pjesa e poshtme e tunelit të derivimit drejt centralit, supozohet të jetë vendosur në gurë relativisht të fortë ofiolitikë dhe rekomandohet të gjërmohet nga një metodë konvencionale shpim e shpërthim.

- Tuneli i prurjeve supozohet të gjërmohet në shkëmbinj pjesërisht të fortë ofiolitikë dhe rekomandohet të gjërmohet nga një metodë konvencionale shpim e shpërthim.

Plani nëntokësor në zonën e centralit konsiston në elementet e mëposhtme:

- Centrali dhe shpella e transformatorëve;
- Tuneli i kalimit për në ndërtesën e centralit;
- Tuneli kabllor dhe ai i shpëtimit nga centrali për në sipërfaqe;

- Tuneli i inklinuar i derivimit gërmuar nga shpella e centralit;
- Tuneli shkarkues fundor.

Punimet nëntokësore në zonën e centralit supozohet të gërmohen në shkëmbinjtë relativisht të fortë ofiolitike me cilësi të masës shkëmbore, kryesisht mesatare me disa seksione të varfra dhe shkëmbinjtë jashtëzakonisht të dobët. Të gjitha këto tunele dhe shpella rekomandohen të gërmohen nga metoda shpim e shpërthim.

Çështje mjedisore të një rëndësie specifike për fizibilitetin dhe projektimin

Si pasojë e krijimit të Rezervuarit të Moglicës, zonat tokësore në luginën e sipërme të Devollit do të përmblyhen mbi një gjatësi prej përafërsisht 22 km. Ndikimet sociale dhe mjedisore janë identifikuar dhe masat për minimizimin e tyre përshkruhen në raportin e VNMS-së. Ndikimi kryesor mjedisor mund të shihet në lidhje me ndryshimet në regjimin hidrologjik të lumit të Devollit. Devijimi i ujit në digën e Moglicës do të pakësojë prurjet në Devoll në zonën midis sheshit të digës dhe rezervuarit të Kokelit. Kjo do të zbutet me shkarkim të rrjedhës minimale. Ndikimet sociale kryesore janë humbja e tokës bujqësore dhe hortikulturave dhe humbja e standardeve të jetesës e kushtëzuar nga to. Nevojitet risistemimi i shtëpive në 2 fshatra, Nikollare dhe Lumaj dhe zëvendësimi i infrastrukturës ekzistuese (si p.sh.: shkolla dhe infrastruktura shëndetësore, rindërtimi i rrugëve etj.). Minimizimi i duhur i pasojave do të iniciohet në bashkëpunim me qeverinë e Shqipërisë kur të jetë e përshatshme si për mjedisin ashtu edhe për personat e prekur nga projekti.

D. Skema e përgjithshme e hec-it të Kokelit

Hec-i i Kokelit përdor një lartësi shfrytëzimi prej 55 m mes lartësisë 350 m m.n.d. dhe lartësisë 295 m m.n.d. në lumin Devoll, të krijuar nga diga e Kokelit përafërsisht 53 m e lartë, e projektuar si një digë graviteti prej betoni e lidhur me një digë me mbushje shkëmbore me shtresë asfalti drejt shpatit të djathtë. Centrali dhe shkarkuesi fundor janë të vendosur në shpatin perëndimor në këmbë të digës prej betoni. Në 5 m e fundit të lartësisë së shfrytëzimit janë marrë duke ulur shtratin e lumit, duke ndërtuar kanale në një gjatësi prej përafërsisht 600 m nga dalja e tunelit shkarkues fundor.

Në zonën e projektit mund të arrihet nga zonat e rrjedhjes së sipërme dhe ato të poshtme nga një rrugë që shkon paralelisht me lumin përmes luginës së Devollit.

Projekti i Kokelit përfshin këto pjesë kryesore:

- Rrugët hyrëse;
- Digën e Kokelit, që përfshin:
 - një seksion të digës me mbushje shkëmbore dhe shtresë asfalti. Një seksion dige graviteti prej betoni me vepra hyrëse tubacione për në central kapërderdhës dhe tuba për pastrimin e sedimenteve dhe devijimin gjatë ndërtimit;
 - Një pus shuarjeje;
 - Një central mbi sipërfaqen e tokës me pajisje prodhimi energjie;
 - Një kanal shkarkues fundor;
 - Një godinë me ingranazh kontrolli të izoluar me gaz; dhe
 - Lidhjen me linjën e transmetimit 220 kV Elbasan II - nënstationi i Moglicës.

Zona e Kokelit, kushtet e themelit

Kuadri gjeologjik në sheshin e digës së Kokelit është i formuar nga litologjitë e kufirit të ofioliteve ultrabazike të masivit të Devollit. Në aspektin tektonik, ato i përkasin zonës së Mirditës.

Rezultatet e shpimit dhe hartëzimi i detajuar tregojnë se sheshi i digës karakterizohet nga litologjitë e kufirit (sekuencat Melangje) të masivit të Devollit, të cilat mund të ndahen në tri nënloje. Ato janë vërtet kombinime tektonike melangje me përbërje heterogjene.

Shpati i majtë i digës është ndërtuar nga amfibolite dhe serpentite të zonës argjilore. Të monitoruara në një shkallë më të madhe, këto amfibolite dhe serpentinite janë thjesht trupa të prerë në zonën argjilore të thërrmuar, por si trupa të prerë janë mjaftueshëm të mëdhenj për të krijuar një shpat të majtë të qëndrueshëm me kushtet më të mira të mundshme të masës shkëmbore.

Mund të supozohet për centralin se pjesa më e mirë e gropës/tunelit të gërmuar do të ndodhet në sedimente aluviale të lumit të Devollit, të gërshetuara me papastërti nga shpati i majtë. Shpati perëndimor i tunelit/gropës së centralit ka shumë gjasa që të jetë shkëmb amfobolitik.

Sjellja e masave gurore gjatë gërmimit do të përcaktohet nga një pjesë ranore dhe orientimit të përmbajtjes së preferuar.

Niveli zero i gërmimit të centralit të Kokelit është përafërsisht 280 m m.n.d. Gërmimi do të rezultojë në gropa të pjerrëta deri në një lartësi prej 30 m përgjatë skajit jugperëndimor. Në përgjithësi orientimi që përkulet paralel me luginën nuk është i favorshëm. Pjerrësia e shpatit, lartësia e mureve dhe mbështetja e përforcuar, si edhe shtrëngimi me gurë sistematikë dhe/ose ankorimi, duhet të projektohen sipas cilësive të masiveve shkëmbore mekanike dhe analizës së detajuar të përmbajtjes që është për t'u kryer në fazën e ardhshme të projektimit.

Çështje mjedisore të një rëndësie specifike për fizibilitetin dhe projektimin

Si pasojë e krijimit të rezervuarit të Kokelit, zonat tokësore në mes të luginës së Devollit do të përmblyen mbi një gjatësi prej përafërsisht 5.4 km. Ndikimet sociale dhe mjedisore janë identifikuar dhe pakësuar siç përshkruhet në raportin e VNMS-së. Ndikimet sociale janë të moderuara në krahasim me ato të hec-it të Banjës dhe hec-it të Moglicës, por ka humbje të tokës bujqësore dhe hortikulturave, si edhe humbja e standardeve të jetesës e kushtëzuar nga to. Ka një vend me specie bimësh endemike në zonën në të cilën mund të ketë impakt për shkak të punimeve ndërtimore. Minimizimi i duhur i pasojave do të iniciohet në bashkëpunim me qeverinë e Shqipërisë, kur të jetë e përshtatshme, si për mjedisin ashtu edhe për personat e prekur nga projekti.

E. Skena e përgjithshme e hec-it të Banjës

Hec-i i Banjës përdor një lartësi shfrytëzimi mes 175 m m.n.d. dhe 95 m m.n.d. Hidrocentrali ndodhet përafërsisht 14 km poshtë rrjedhës në qytetin e Gramshit. Plani i përgjithshëm është në parim i njëjtë me planet fillestare shqiptare për projektin. Diga dhe tuneli i derdhjes është lënë pjesërisht i përfunduar, pasi zona u braktis në vitet '90.

Rezervuari i krijuar nga diga e Banjës do të jetë përafërsisht 80 m i lartë. Si masë për pakësimin e përmblyjes, struktura e digës mund të bëhet që të përballojë nivelin më të lartë gjatë operimit (OFWL) prej 176.5 m m.n.d. Diga është projektuar si një digë argjiture me bërthamë të papërshkueshme argjile. Hyrja në rezervuarin e Banjës ndodhet pak sipër digës në shpatin e majtë të lumit të Devollit. Hyrja me porta për mbylljen e tunelit të derivimit do të instalohet në një kullë të ndarë. Një portë çeliku do të drejtojë ujin te centrali që ndodhet në sipërfaqe. Nga centrali, një kanal shkarkues fundor do ta kthejë ujin në lumë. Hidrocentrali do të pajiset me dy njësi Francis dhe një njësi të vogël për shkarkimin minimal me një total të kombinuar të kapacitetit të turbinave prej 63.4 MW+min 1.4 MW.

Madhësia e njësisë së vogël mund të rritet, në mënyrë që të shërbejë më mirë për ujin për vaditje. Mesatarja vjetore e përlllogaritur për prodhimin e energjisë është 252 GWh.

Devijimi ekzistues i lumit nën digë do të vihet në funksion për kohëzgjatjen e punimeve të ndërtimit, por do të bëhet i përhershëm pas mbylljes së parë. Një mundësi tjetër për të ulur nivelin e ujit në rezervuar mundësohet nëpërmjet një degëzimi në porta dhe një kanali emergjence për uljen e nivelit.

Hidrocentrali i Banjës përfshin këto pjesë kryesore:

- rrugët hyrëse;
- digën e Banjës;
- kapërderdhësin;
- veprën e marrjes, tunelin e derivimit (veshje çeliku në tunel dhe porta pjesërisht nëntokë);
- central mbi sipërfaqen e tokës me pajisje prodhimi të energjisë;
- kanal shkarkues fundor;
- sistem për të mbledhur sedimentet; dhe
- një dalje emergjence (degëzim i portës dhe i kanalit);

- nënstacion;
- linjë të re transmetimi 110 kV 11.5 km të gjatë deri në nënstacionin e Cërrikut;
- rindërtim të linjës 35 kV mes Banjës dhe Mjekës.

Gjeologjia e zonës së Banjës

Në zonën e Digës së Banjës fiziografia e luginës së Devollit është ajo e një lugine të gjerë lumore. Brenda bazës së luginës hasen depozitime aluviale, që shtrihen mbi një formacion me përmbajtje flishesh. Depozitimet aluviale vlerësohet të jenë mes 5 m deri 15 m të gjera.

Anët e luginës janë të mbuluara nga një shtresë materiali të përthithur nga toka (dhe i gërryer i transportuar poshtë nëpër shpat). Në pjesë të shpateve të luginës mund të gjendet një konglomerat, dobësisht i çimentuar, mbi themelet me flishe. Konglomerati mund të jetë, gjithashtu, i pranishëm nën depozitat aluviale në bazë të luginës. Duhet të parashikohen burime në kontakt me konglomeratet.

Thellësia e erozionit të themelit prej flishesh është raportuar të variojë nga 0.5 m deri në 1.5 m nën depozitat aluviale brenda shtratit të lumit mes 4 m deri në 8 m mbi shpatet e luginës.

Struktura gjeologjike në zonën e digës është e karakterizuar nga një strukturë e pjerrët sinklinale, aksi i së cilës përkulet drejt juglindjes në drejtim të rrjedhës së sipërme. Struktura sekondare sinklinale dhe antiklinale janë të pranishme. Një thyerje masive e përkulur kalon nëpër kufirin e djathtë. Raportime të mëparshme sugjerojnë që ka pasur zhvendosje “të vogla” përgjatë kësaj thyerjeje.

Vetë diga ekzistuese e Banjës është kryesisht e ndodhur në një zonë të dominuar me gurë ranorë, rrallëherë të ndërthurur me gurë argjilorë. Rezervuari i hidrocentralit të Banjës është tërësisht i ndodhur në formacionin e flisheve të Krujës.

Çështje mjedisore të një rëndësie specifike për fizibilitetin dhe projektimin

Si rezultat i krijimit të Rezervuarit të Banjës, zonat tokësore në luginën e poshtme të Devollit do të përmbeten në një shtrirje prej përafërsisht 13.5 km. Ndikimet sociale dhe mjedisore janë identifikuar dhe masat për pakësimin e tyre janë përshkruar në raportin e VNMS-së. Ndikimi kryesor mjedisor mund të shihet në lidhje me ndryshimet në regjimin hidrologjik të lumit të Devollit. Regjimi hidrologjik do të ndryshojë në rrjedhën e poshtme të digës së Banjës. Kjo do të pakësohet me shkarkim minimal të qarkullimit. Ndikimet sociale janë humbja e tokës bujqësore dhe hortikulturave, si edhe humbja e standardeve të jetesës së kushtëzuar nga to. Është identifikuar, gjithashtu, nevoja për zhvendosjen e shtëpive përgjatë rezervuarit dhe një nevojë për të zëvendësuar infrastrukturën ekzistuese (si p.sh.: shkolla, rindërtim të rrugëve dhe urave etj.). Minimizimi i duhur i pasojave do të iniciohet në bashkëpunim me qeverinë e Shqipërisë, kur të jetë e përshtatshme, si për mjedisin ashtu edhe për personat e prekur nga projekti.